



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 148

Tiranë – E enjte, 12 tetor 2023

PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 581, datë 11.10.2023

Për disa shtesa në vendimin nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, të ndryshuar.....

Faqe

16183

**VENDIM****Nr. 581, datë 11.10.2023**

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 425, DATË 27.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM NË PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun II, të vendimit nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1 Përfundimisht, në rastet e situatave emergjente dhe kur nga zbatimi i procedurës dhe afateve të parashikuara në këtë vendim rrezikohet gjendja e pasurive kulturore, autoriteti kontraktor shoqëron urdhrin e konkurrencës me relacionin argumentues mbi ekzistencën e situatës emergjente për ndërhyrje në pasuri kulturore, e cila nuk duhet të jetë shkaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.”;

b) Pas pikës 13 shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

“13/1 Në rastet e situatave emergjente, sipas parashikimit në pikën 9/1, njoftimi për konkurrim publik publikohet në Buletin e Njoftimeve Publike dhe në faqen elektronike të institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, të paktën 3 (tri) ditë përpara dorëzimit të ofertave;”;

c) Pas pikës 23/2 shtohet pika 23/3, me këtë përmbajtje:

“23/3 Në rastin e situatave emergjente, sipas parashikimit të pikës 9/1, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, brenda 2 (dy) ditëve nga dita e hapjes së ofertave.”.

ç) Pas pikës 24 shtohet pika 24/1, me këtë përmbajtje:

“24/1 Në rastin e situatave emergjente, sipas parashikimit të pikës 9/1, ankimi për procedurën e konkurrencës publik bëhet te titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën brenda 2 (dy) ditëve nga e nesërmyja e marrjes dijeni të njoftimit.”.

d) Pas pikës 25 shtohet pika 25/1, me këtë përmbajtje:

“25/1 Në rastin e situatave emergjente, sipas parashikimit të pikës 13/1, njoftimi i fituesit për lidhjen e kontratës kryhet brenda 1 (një) dite nga njoftimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore (DRTK) dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 16 lekë